



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 201800113/2

Tiranë ___/___/2018

Lënda: *Rekomandojmë marrjen e masave për ndërhyrjen e menjëhershme dhe hartimin e planit të mbrojtjes për të siguruar mirëqenien e fëmijëve të shtetasve I.D.*

Drejtuar: **Bashkia FIER**
Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve

FIER

Duke marrë shkas nga publikimi në një media të datës 18.01.2018 me titull "*Historia e dhimbjes/Nëna lëngon në shtrat, Gjyshja e verbër rrit dy fëmijët*", Zyra e Avokatit të Popullit e regjistroi për ta trajtuar si rast me iniciativë.

Konkretisht bëhet fjalë për historinë e dhimbshme të familjes së **Zj.D. D., e cila është e verbër dhe i duhet të kujdeset për fëmijët e së bijës I.D e cila vuan nga një sëmundje e rëndë në mushkëri.**

Sapo ka mbushur 24 vjeç dhe është nëna e dy të miturve. Historia e I.D nga Fieri është bërë pjesë e emisionit me 'Zemër të hapur', ndërsa ajo po jeton ditët e saj me të këqija, pasi mjekët e kanë diagnostikuar me një sëmundje të rëndë në mushkëri. Nëna e saj, D. D, që për fat të keq është e verbër totalisht, apelon për ndihmë në mënyrë që të rrisë nipërit e saj. Pavarësisht dramave të mëdha, 54-vjeçarja kërkoi ndihmë që t'i kthehej shikimi, që të kujdesej për të miturit dhe vajzën e saj. Thirrjes së saj për tu kuruar i është përgjigjur pozitivisht një spital privat, ku dhe do të operohet.

Pjesë të artikullit po citojmë: "Vajza e Zj.D.D, ishte 12 vjeç kur prindërit e saj u divorcuan, dhe babai i braktisi përgjithmonë. Ajo ra pre e trafikut kur emigroi ilegalisht në Itali, dhe tashmë ka dy fëmijë (një djalë e një vajzë) atësinë e të cilëve nuk e di-shprehet artikulli. Në fakt gjyshja kujdeset për ta, por janë dy të vegjlit që kujdesen për gjyshen dhe nënën e tyre (Ina) që lëngon në shtrat. Vajza 6 vjeçare ndjek klasën e parë, ndërsa djali 3-vjeçar pret të motrën të vijë nga shkolla e t'i japë atë pak bukë që i ka mbetur në sirtar. Panorama në këtë familje është ulëritëse, është një dhimbje teksa shikon këta të mitur që I luten zotit për nënën e tyre, ku ajo të shërohet dhe të luajë me ata si më parë. Nga ana tjetër 24 vjeçarja rënkon prej kohësh në krevat dhe gjendja e saj shëndetësore sa vjen dhe rëndohet. Gjyshja e tyre lutet përditë tu sigurojë bukën e fëmijëve duke lypur. Në këtë qytet të madh askujt nuk i shkon në mendje t'i ndihmojë. Dyert e Shërbimit Social Shtetëror dhe Bashkisë ndodhen përherë të mbyllura, kur flitet për të tilla familje".

Neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton se "*Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti*". Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë përcakton në

nenin 5 se: “ 1.Të drejtën për të përdorur shërbimet e kujdesit shoqëror e kanë individë ose familje që nuk kanë mjetet minimale të jetesës dhe nuk janë në gjendje që t’i sigurojnë ato me punë apo të ardhura nga pronat ose burime të tjera, si dhe të gjithë individët që janë në pamundësi për të plotësuar nevojat e tyre të jetesës, vetë ose me ndihmën e anëtarëve të familjes, për shkak të kushteve personale dhe sociale”. Detyrimin ligjor për fuqizimin e familjeve në kushtet e vështira social-ekonomike e ka pushteti vendor.

Në zbatim të Udhëzimit nr. 10 datë 25.2.2015 “Për mënyrat, format e bashkëpunimit dhe procedurat e ndërhyrjes në ndihmë të fëmijëve në rrezik për institucionet dhe strukturat kryesore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijës” vlerësimi i familjes bëhet nga një ekpi multidisiplinar, pjesë e të cilit është dhe përgjegjësi i ndihmës ekonomike por edhe përfaqësues të strukturave të ndryshme, si Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve, Zyrat e Punës etj., të cilët realisht kryejnë një vlerësim gjithëpërfshirës duke e vënë theksin në interesin më të lartë të fëmijëve.

Rasti konkret ka të bëjë me mbijetesën dhe problematikat e një nëne 54 vjeçare të verbër, vajzës së saj 24 vjeçare që vuan nga një sëmundje e rëndë dhe dy fëmijëve të saj të mitur, ndaj ky rast konsiderohet mjaft kompleks dhe emergjent për ndihmë.

Ndaj bazuar në VKM nr. 266 datë 12.04.2012 “Për bashkërendimin e veprimtarisë së mekanizmave në nivel qendror dhe vendor për çështjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave të fëmijës” dhe Udhëzimin nr.10, datë 25.2.2015 të sipërcituar, si dhe në zbatim të nenit 21 të ligjit **Nr.8454, datë 4.2.1999, ”Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar** “*paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive*” si dhe duke patur parasysh parimin e interesit më të lartë të dy fëmijëve

REKOMANDOJMË:

Vlerësimin e nevojave të fëmijëve të Zj. I.D dhe hartimin e planit të mbrojtjes për të siguruar mbijetesën dhe mirëqënien e fëmijëve të saj.

Në përputhje me nenin 22 të Ligjit Nr.8454, datë 4.2.1999 “Për Avokatin e Popullit në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar ku përcaktohet se: “*Organet të cilave Avokati i popullit u ka drejtuar një rekomandim, duhet ta shqyrtojnë rekomandimin dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimi*”, lutemi ta shqyrtoni dhe të na vini në dijueni për qëndrimin Tuaj ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe në vijimësinë e bashkëpunimit në funksion të garantimit të interesit më të lartë të fëmijëve,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI